

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të VKM nr.243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

- **1 (një) Specialist (Burimeve Njerëzore) në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë- klasa IV-1**

Pozicioni u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se pozicioni, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL)
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

LËVIZJE PARALELE

01.12.2024

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

PRANIM NË SHËRBIM CIVIL

05.12.2024

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Ndjek dhe zbaton procedurat ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me rekrutimin, vlerësimin e rezultateve në punë, regjistrimin e lëvizjes së punonjësve, menaxhimin e dosjeve të personelit dhe dhënies së informacioneve mbi indikatorët e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Mbështet nevojat e veprimtarisë së institucionit me burime të kualifikuara njerëzore dhe kujdeset për zhvillimin e karrierës së tyre nëpërmjet kualifikimeve, trajnimeve dhe zhvillimit të tyre;
- Mbështet njësitë organizative të institucionit në lidhje me proceset e parashikuara në legjislacion për nëpunësin civil në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë, masat disiplinore dhe hartimin e përshkrimeve të punës.
- Zbaton procedurat ligjore në lidhje me administrimin e dosjeve të personelit dhe sistemit HRMIS.
- Merr pjesë në procesin e hartimit të strukturës dhe organikës së institucionit dhe realizimin e politikave dhe veprimtarive që lidhen me fushën e burimeve njerëzore.

1-LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
- b) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (vërtetuar me dokument nga institucioni);
- c) Të kenë të paktën një vlerësim fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional” në Shkenca Shoqërore, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë jo më pak se 1 vit përvojë pune në profesion, ose të kenë përvojë në fushën e burimeve njerëzore.
- c) Të kenë njohuri të një gjuhe të BE-së (anglisht, italisht, gjermanisht, frengjisht).

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass, linku:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;*
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil;
- f- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
- h- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
<https://ild.al/dokonline/Formular-vetdeklarimi-gjendje-gjyqesore.pdf>
- i- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt (6 mujori i parë i vitit 2024);
- j- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- k- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara mësipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, brenda datës **01.12.2024**.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për skualifikim të kandidatit.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **03.12.2024** njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallë në stendat e informimit me publikun, në faqen zyrtare të internetit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Njohuritë mbi VKM nr. 142, datë 12.3.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM nr. 243, datë 18.3.2015, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM nr. 242, datë 18.3.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM nr. 109, datë 26.2.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM nr. 124, datë 17.2.2016, "Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM nr. 125, datë 17.2.2016, "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë";
- Njohuritë mbi VKM nr. 115, datë 5.3.2014, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil";
- Njohuritë mbi VKM nr. 117, datë 5.3.2014, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit";
- Njohuritë mbi Ligjin nr.9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike, www.dap.gov.al

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët do të paraqiten në Komisionin e Brendshëm për Lëvizjen Paralele, brenda 3 ditëve kalendarike nga njoftimi individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 3 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të procesit të ankimimit nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare dhe në stendën e informimit të publikut. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

2- PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

*Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke filluar nga **data 20/12/2024***

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional” në Shkenca Shoqërore edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Të kenë jo më pak se 1 vit përvojë pune në profesion, ose të kenë përvojë në fushën e burimeve njerëzore.
- c) Të kenë njohuri të një gjuhe të BE-së (anglisht, italisht, gjermanisht, frengjisht).

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass, linku:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;*
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
<https://ild.al/dokonline/Formular-vetdeklarimi-gjendje-gjyqesore.pdf>
- h- Vërtetim nga gjykata;
- i- Vërtetim nga prokuroria;
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara mësipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, brenda datës **05.12.2024**

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për skualifikim të kandidatit.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **20.12.2024**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të shpallë në stendat e informimit me publikun, në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit për shkaqet e moskualifikimit, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Njohuritë mbi VKM nr. 142, datë 12.3.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM nr. 243, datë 18.3.2015, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM nr. 242, datë 18.3.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM nr. 109, datë 26.2.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM nr. 124, datë 17.2.2016, "Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM nr. 125, datë 17.2.2016, "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”;
- Njohuritë mbi VKM nr. 115, datë 5.3.2014, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”;
- Njohuritë mbi VKM nr. 117, datë 5.3.2014, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;
- c- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;

Nëse kandidati grumbullon më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë), nga vlerësimi me shkrim, ai kualifikohet për të kaluar në procesin e vlerësimit të jetëshkrimit.

Nëse kandidati grumbullon mbi 45 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike, www.dap.gov.al

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail, mbi rezultatit vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimit të jetëshkrimit, si dhe për intervistën strukturuar me gojë.

Ankesat nga kandidatët, do të paraqiten në Komitetin e Përherëshëm të Pranimit, brenda **5** ditëve kalendarike nga njoftimi individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda **5** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të afatit të ankimimit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të shpallë fituesin në stendat e informimit me publikun, në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Kandidatë fitues janë kandidatët që kanë marrë mbi 70 pikë (70% të pikëve), duke u renditur nga kandidati me rezultatit më të lartë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke filluar nga data: **20/12/2024**.